



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 582/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD), me seli në Prizren, paraqitur kundër Qendrës së Votimit (QV), me seli në Prizren për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, dhe manipulimit të votave, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD), me seli në Prizeren: Anr.582/2013, Anr.584/2013, Anr.585/2013, Anr.586/2013, Anr.587/2013, Anr.588/2013, Anr.589/2013, Anr.590/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar 8 (tetë) ankesa: Anr.582/2013, Anr.584/2013, Anr.585/2013, Anr.586/2013, Anr.587/2013, Anr.588/2013, Anr.589/2013 dhe Anr.590/2013, nga subjekti politik Bashkimi Demokratik BD, me seli në Prizren, me të cilat pretendohet se ka ndodhur parregullsi gjatë procesit të votimit, dhe manipulimit të votave, gjatë ditës së votimit, në Zgjedhjet lokale të 3 Nëntorit 2013.

- Në ankesën Anr.582/2013, pretendohet se kanë ndodhur parregullsi të evidentuara nga vëzhguesit e këtij subjekti në Qendrën e Votimit QV 2004A, ku në të gjitha klasat, është bërë anulim i qëllimshëm i këtij subjekti për asamble komunale nga ana e komisionarëve të partive tjera, duke e shfrytëzuar mungesën e komisionarëve të tyre, theksohet në ankesë, gjithashtu nga parashtruesi kërkohet që të numërohen votat e shpallura të pavlefshme.
- Në ankesën Anr.584/2013, pretendohet se kanë ndodhur parregullsi të evidentuara nga vëzhguesit e tyre në QV 2005a dhe 2005x, kështu që votat e vlefshme për Kuvend Komunal nga ana e komisionarëve janë shpallur të

pavlefshme, si dhe nga parashtruesi i ankesës kërkohet rinumërimi i votave të shpallura të pavlefshme në këtë QV

- Në ankesën Anr.585/2013, pretendohet se ka ndodhur parregullsi në QV 2006A, ku është bërë anulimi i subjektit për asamble komunale nga ana e komisionarëve të partive tjera në mungesë të komisionarëve të subjektit të BD-së. Ku parashtruesi i ankesës kërkohet të behet numërimi i votave të shpallura pavlefshme në këtë QV.
- Në ankesën Anr.586/2013, pretendohet se ka pasur parregullsi në QV 2005A, të evidentuara nga vëzhguesit e këtij subjekti, ku është bërë anulim i qëllimshëm të subjektit ton për asamble komunale nga ana komisionarëve të partive tjera, duke shfrytëzuar mungesën e komisionarëve të BD-së, dhe kërkohet që të bëhet numërimi i votave të pavlefshme.
- Në ankesën Anr.587/2013, po ashtu pretendohet se ka pasur parregullsi të ndodhura dhe të evidentuara nga vëzhguesit e BD-së në QV2033A, përkatësisht është bërë anulimi i qëllimshëm në të gjitha klasat i subjektit BD, për Asamble Komunale nga ana e komisionarëve të partive tjera , duke shfrytëzuar mungesën e komisionarëve të BD-së. Parashtruesi i ankesës kërkon të bëhet numërimi i votave të shpallura të pavlefshme.
- Në ankesën Anr.588/2013, pretendohet se ka ndodhur parregullsi të evidentuara nga vëzhguesit e këtij subjekti, në QV 2016A, në të gjitha klasat është bërë anulim i qëllimshëm të subjektit tonë për asamble komunale nga ana e komisionarëve të partive tjera, duke shfrytëzuar mungesën e komisionarëve të këtij subjekti prandaj kërkohet të bëhet numërimi i votave të shpallura të pavlefshme.
- Në ankesën Anr.589/201, edhe në këtë ankesë pretendohet se ka parregullsi të QV 2003A, të evidentuara nga vëzhguesit e këtij subjekti, ku është bërë anulim i qëllimshëm i këtij subjekti për Asamble Komunale nga ana e komisionarëve të partive tjera, duke shfrytëzuar mungesën e komisionarëve tonë, prandaj kërkohet të bëhet numërimi i votave të shpallura të pavlefshme.
- Si dhe në ankesën Anr.590/2013, pretendohet parregullsi në QV 2025A, ku parashtruesi i ankesës kërkon të rinumërohen të gjitha votat e pavlefshme sepse theksohet se janë të bindur se votat e subjektit të tyre janë prishur me qëllim të caktuar , si dhe kemi prova që nuk janë të prishura, por janë të shpallura si të prishura.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 te Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka

shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD), se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa, lidhur me ndodhjen dhe evidentimin e parregullsive në Qendrat e Votimit 2004A, 2005a, 2006A, 2005A, 2033A, 2016A, 2003A dhe 2025A, janë të pabazuara, nga shkakut se nga parashtruesi i ankesës nuk është bashkangjitur asnjë provë ankesave të parashtruara, me të cilat do të mund të administroheshin lëndët, ose do të mund të verifikohej vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar parregullsi nga vëzhguesit e subjektit të lartcekur, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 582/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*